

STATUT

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ GJELBERIMI ” SHPK

KORCE ME 15.07.2011

KREU I

EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA, SELIA, ADRESA E FAQES SE INTERNETIT.

Neni 1

Emri.

1.1 Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet “ GJELBERIMI ” SHPK, e cila me poshte do te quhet shoqeria.

1.2 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj tregtare.

Neni 2

Objekti.

2.1 Objekti I veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar shqiptar do te jete:

- a.Studime,projektme dhe zbatime ne fushen e pyjeve dhe gjelberimit.
- b.Prodhim dhe tregetim fara dhe fidane
- c. Sherbime profesionale per projektme ne pyje.
- d. Sherbime profesionale per zbatime ne pyje.
- e.Mirembajtje te ambjenteve te gjelbra,projektim paisazhi,(sistemim lulishte vepra arti dhe dekori).
- f.Grumbullim bimesh medicinale dhe tregetim te tyre ,import-eksport.
- g.Tregti plehrash kimike,pesticidesh import-eksportin e tyre si dhe punime te tjera ne sferen e bujqesise.
- h.Tregetim me shumice e pakice import eksport te artikujve bujqesore,blegtorale,ushqimore e industrial.



i.Pastrim sipërfaqe urbane (grumbullim, përpunim, transport të mbeturinave)

j.Kryerje të punimeve në shërbimet funerale.

Neni 3

Kohezgjatja.

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

Neni 4.

Selia, adresa e faqes së internetit, dhe adresa elektronike.

4.1. Selia e shoqërisë është në Fshatin Kamenice, Komuna Mollaj, Korçë.

4.2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

4.3. Shoqëria mund të hap apo të mbyll filiale, degë dhe/ose zyre përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

4.4. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është www.gjelberimi@yahoo.com

4.5. Adresa e shoqërisë për qëllime të komunikimit elektronik është si vijon: email XXXXXXXXX

KREU II

KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 5

Vlera e kapitalit të regjistruar.


5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 3,929,000 leke (tremilione nentëqindnjzetënetëmijë leke)

5.2. Pronësia mbi kapitalin themeltar të shoqërisë është vetëm e ortakut të vetëm Z.Besnik Mancelli.

Neni 6.

Kontributet.

6.1 Kontributi në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:



Z.Besnik Mancelli, 3,929,000 leke (tremilionenteqindenjezetentemije) leke

Neni 7.

Pjeset e kapitalit themeltar.

7.1. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 3929 pjese , me vlere nominale 1000 (njemije) leke secila, te renditura sipas numrit te series nga 1 ne 3929.

Neni 8.

Kalimi me kontrate i kuotave.

8.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme tek personat e trete , nese ortaku i vetem vendos per kete.

Neni 10.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.

10.1. Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise behet me vendim te ortakut te vetem.

KREU III.

ASAMBLEA E PERGJITHSHME.

Neni 11.

11.1 Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem.

11.2. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te shihen. Duhet regjistruar ne veçanti , por pa u kufizuar vetem ne to , vendimet per:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.


b) shperndarjen e itimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.

c) investime.

d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Neni 12.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme.



12.1 Asambleja e Pergjithshme , e perbere nga ortaku I vetem. Mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji, nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur intereset e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

12.2. Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori ose nga ortaku I vetem I shoqerise.

KREU IV.

ADMINISTRATORI

Neni 13.

Emerimi,shkarkimi,te drejtit dhe detyrimet.

13.1. Asambleja e Pergjithshme , e cila perbehet nga ortaku I vetem, emeron si Administrator te shoqerise Z.Besnik Mancellii

13.2. Administratori I shoqerise emerohet per nje afat prej 3 vjet, me te drejte ripertitje. Emerimi I administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

13.3.Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

a- Kryeje te gjithë veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku I vetem;

b- Perfaqesoje shoqerine tregtare;

c- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise;

d- Raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e- Kryen detyra te tjera te caktuara me statut e me ligj.

Neni 14.

Procesverbalet e mbledhjeve te Administratoreve,


14.1 Administratori kujdeset qe te hapen libra te posaçem e te mbahen procesverbale te :

a) te gjitha takimeve te kryera nga Administratori;

b) te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te perbere nga ortaku I vetem si dhe mbledhjeve me administratorin .

KREU V

DIVIDENTET DHE KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR.



15.1 Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit.

15.2 Ortaku i vetem percakton fitimin e vitit financiar pasi te jene zbritur me pare shumat per:

a- rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga ortaku i vetem.

b- fonde te tjera te nevojshme.

15.3 Ortaku i vetem percakton dhe miraton dividendin.

Neni 16.

Kalimi i fitimeve ne Kapitalin Themeltar.

16.1. Me vendim te ortakut te vetem te shoqerise, fitimet e pashperndara , te cilat nuk do te perdoren per te paguar shumata te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise, do te kalojne ne Kapitalin Themeltar te shoqerise.

KREU VI

PRISHJA DHE NJOFTIMET.

17.1 Shoqeria priset me vendim te ortakut te vetem ose per arsye te parashikuara me ligj.

17.2. Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin qe ortaku i vetem merr vendim per prishjen e saj dhe caktimin e nje ose disa likujdatoreve te cilet pergatisin raportin mbi gjendjen e ativity dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

17.3 Ne perfundim te procesit te likujdimit, ortaku i vetem miraton bilancin perfundimtar financiar dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

17.4. Ne perfundim te procesit te likujdimit , pas shlyerjes dhe pagimit te kreditoreve, ortaku i vetem mban pjesen e mbetur te kapitalit.

Neni 18.

Njoftimet.

18.1. Ky statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentat e tjera, raportet, komentet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria , do te publikohen nga Administratori ne faqen e internetit te shoqerise , sipas parashikimeve te nenit 4 te ketij Statuti.

Ortaku i vetem

Besnik Mancelli.


GJENREBIMI Sh.p.k
imo exp
CRÇE ALBANIA